



## Këshilli i Sigurimit

Distr.: General  
1 May 2018

Original: English

### **Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

#### **I. Hyrja dhe prioritetet e Misionit**

1. Ky raport paraqitet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli vendosi të themelojë Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi që unë të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Në raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to prej datës 17 janar deri më 15 prill 2018.
2. Prioritetet e Misionit mbesin promovimi i sigurisë, stabilitetit dhe respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me zbatimin e roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Misioni i Bashkimit Evropian për



Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) vazhdon me praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e presidentit të Këshillit të Sigurimit të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara kanë bashkëpunim të ngushtë me Misionin në avancimin e iniciativës “të veprojmë si një”.

## I. II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Një sërë zhvillimesh gjatë periudhës raportuese ngritën tensionet dhe ndikuan negativisht në marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Në mars, pas vazhdimit të dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian në mes të Beogradit dhe Prishtinës, autoritetet e Kosovës ju përgjigjën negativisht njoftimit se drejtori i zyrës për Kosovë i Qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriq, do të udhëtonte në veri të Mitrovicës, dhe e paralajmëruan atë të mos e realizojë vizitën. Mirëpo, më 26 mars, z. Gjuriq udhëtoi në veri të Mitrovicës për të marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët mbi dialogun e brendshëm për Kosovën të Presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, së bashku me një anëtar të kabinetit të Presidentit Vuçiç, tre ministra të Qeverisë së Kosovës dhe liderë lokalë të Kosovës. Njësitë speciale të Policisë së Kosovës hyn në objektin ku mbahej takimi dhe, duke përdorur shok granada dhe gaz lotësjele, e arrestuan z. Gjuriq. Disa njerëz u lënduan, duke përfshirë ministrin e bujqësisë së Kosovës, të listës serbe nga Partia për Kosovë, i cili u hospitalizua për tri ditë, dy kryetarë komunash, gazetarë dhe spektatorë. Z. Gjuriq u trajtua me ashpërsi nga Policia e Kosovës gjatë një rruge qendrore në Prishtinë, para mediave dhe shikuesve,

dhe u dërgua në një stacion të policisë. Pas një dëgjimi të shkurtët gjyqësor, ai u transferua nga Prishtina dhe u lirua në vendkalimin kufitar administrativ 3.

4. Presidenti Vuçiç e përshkroi arrestin dhe mbajtjen e z. Gjuriqit si “poshtërim”, një “provokim brutal” dhe kundër protokolleve të miratuara. Lidhshipi i Kosovës veprimin e quajti reagim të duhur ndaj injorimit të tyre për refuzimin e lejimit të vizitës. Përfaqësuesi im Special për Kosovë i përshkroi ngjarjet e 26 marsit si “të papranueshme”, dhe ju bashkua Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë në thirrjen për qetësi dhe lidhship të përgjegjshëm për të gjithë ata të përfshirë.

5. Incidenti pati pasoja të menjëhershme. Të nesërmen, pas një takimi me Presidentin Vuçiç në Beograd, lidhshipi i Listës serbe lajmëroi qëllimin për t’u tërheq nga koalicioni qeverisës në Kosovë. Lista serbe po ashtu njoftoi se më 20 prill, do të fillonte të punonte njëanshëm për krijimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, ashtu siç parashihej me Marrëveshjen e Parë të 19 prillit 2013 mbi parimet drejtuese të normalizimit të marrëdhënieve. Megjithatë, më 29 mars, zëvendëskryeministri dhe ministri për komunitete dhe kthim i Listës serbe, mori pjesë në një mbledhje të qeverisë të kryesuar nga Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Në atë takim, zëvendëskryeministri tregoi se Lista serbe mbetej e hapur për dialog të kuptimshëm, dhe i bëri thirrje qeverisë të iniciojë një hetim për ngjarjet e 26 marsit dhe të vazhdojë me implementimin e marrëveshjes së vitit 2013, lidhur me krijimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe.

6. Në një zhvillim tjetër rë rëndësishëm, më 29 mars, Policia kufitare e Kosovës arrestoi pesë qytetarë turq me status të qëndrimit të përhershëm në Kosovë, me pretendimin se kanë lidhje me lëvizjen Hizmet/Gülen. Ata u dërguan në stacionin e policisë në Prishtinë dhe me gjasë nuk patën qasje në mbrojtës. Sipas avokatëve të tyre, u revokuan lejet e tyre të qëndrimit, dhe ata u dëbuan nga Kosova për në Turqi po atë ditë. Një qytetar tjetër turk, i gjashti, u arrestua po ashtu në një incident tjetër më 29 mars dhe u dëbua për në Turqi me pesë të tjerët. Presidenti Thaçi dhe kryeministri, z. Haradinaj e dënuan arrestimin dhe dëbimin e shtetasve turq dhe mohuan të kenë pasur njohuri paraprake për operacionin. Duke reaguar ndaj këtij incidenti, më 30 mars z. Haradinaj lajmëroi shkarkimin e ministrit të punëve të brendshme dhe drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, dhe kërkoi hetim të plotë për dëbimin, i pretenduar se është zbatuar në mënyrë të fshehtë. Më 13 prill, kryeministri Haradinaj e caktoi Bejtush Gashin ministër të ri të punëve të brendshme.

7. Para këtyre zhvillimeve, Qeveria e Kosovës përmbushi një kriter të rëndësishëm në procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian kur e ratifikoi marrëveshjen për caktimin e vijës kufitare të nënshkruar me Republikën e Malit të Zi në vitin 2015. Pas disa përpjekjeve të dështuara për mbajtjen e votimit për ratifikim, Kuvendi i Kosovës u mblodh sërish për të votuar më 21 mars. Pjesëtarët e partisë opozitare Vetëvendosje (Lëvizja vetëvendosje) sërish tentuan të pengojnë votimin, duke përfshirë edhe hedhjen e gazit lotësjellës gjatë diskutimeve të Kuvendit. Pas një dekreti të nënshkruar nga kryetari i Kuvendit për të siguruar sallën e Kuvendit, Policia e Kosovës shoqëroi 13 anëtarë të Kuvendit nga radhët e Vetëvendosjes të dalin jashtë sallës së Kuvendit.

Shtatë anëtarë të Kuvendit nga radhët e Vetëvendosjes më pas u arrestuan lidhur me incidentet me gazin lotësjellës. Herët në mbrëmjen e 21 marsit, Kuvendi arriti të vazhdojë me votimin, duke rezultuar me ratifikimin e marrëveshjes me dy të tretat e shumicës së kërkuar.

8. Disa faktorë ndikuan pozitivisht në votimin e ratifikimit, duke përfshirë vizitën e kryeministrit të Malit të Zi në Kosovë, Dushko Markoviç, më 14 shkurt, që ndihmoi në riafirmimin e zotimeve reciproke nga Kosova dhe Mali i Zi në promovimin e marrëdhënieve bilaterale. Së këndejmi, më 16 shkurt, Presidenti Thaçi dhe Presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanoviç, nënshkruan një deklaratë të përbashkët në Podgoricë, ku u pajtuan për krijimin e një organi punues të përbashkët për trajtimin e çdo kontesti lidhur me caktimin e vijës kufitare. Në një deklaratë të përbashkët më 21 mars, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politika të sigurisë, Federika Mogerini, Komisioneri për migracion, punë të brendshme dhe shtetësi, Dimitris Avramopoulos, dhe Komisioneri për politika të fqinjësisë evropiane dhe negociatat për zgjerim, Johannes Hahn, e mirëpritën ratifikimin e marrëveshjes për caktimin e vijës kufitare me Malin e Zi nga Kuvendi i Kosovës, duke theksuar se u përmbush një kriter kyç për liberalizimin e vizave për Kosovën.

9. Në zhvillime të tjera, pas përpjekjes në dhjetor të vitit 2017 nga 43 deputetë të Kuvendit të Kosovës për të anuluar një ligj të vitit 2015, që mbështet punën e Dhomave të Posaçme të Kosovës dhe Prokurorinë Speciale, më 22 janar të vitit 2018 Kuvendi parashtroi kërkesë për mendimin e qeverisë mbi këtë çështje. Më 1 shkurt, z. Haradinaj theksoi se qeveria do të

respektojë procedurën përkatëse para se t'i rikthehet Kuvendit me mendimin e saj. Më 5 shkurt, Presidenti Thaçi, në fjalimin e tij drejtuar qeverisë, potencoi se krijimi i Dhomave të Posaçme ishte i “padrejtë”, por se autoritetet e Kosovës “kishin marrë përgjegjësi dhe obligime të caktuara” dhe se “do t'i përmbushnin ata në pajtim me marrëveshjet e arritura”.

10. Më 6 shkurt, Komisioni Evropian miratoi një strategji të re për angazhimin e Bashkimit Evropian në Ballkanin perëndimor të quajtur “Një perspektivë kredibile e zgjerimit për shtimin e angazhimit të BE-së në Ballkanin perëndimor”. Më 28 shkurt, një delegacion i Bashkimit Evropian ku përfshiheshin Përfaqësuesja e Lartë Mogerini, Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe Komisioneri Hahn, vizituan Prishtinën për të diskutuar rolin e Kosovës në strategjinë e re të Bashkimit Evropian për rajonin, që vazhdon të ketë qasje të lëkundur për integrimin. Gjatë vizitës, delegacioni theksoi se, pa normalizim të efektshëm dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve në mes Beogradit dhe Prishtinës, nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm në rajon, dhe Serbia e Kosova nuk mund të avancojnë në rrugët e tyre përkatëse evropiane.

11. Më 13 shkurt, Misioni i Bashkimit Evropian për Monitorimin e Zgjedhjeve paraqiti raportin përfundimtar për zgjedhjet komunale në Kosovë të datës 22 tetor 2017. Raporti përfshin një sërë rekomandimesh për përmirësimin e proceseve të ardhshme elektorale në Kosovë, të cilat janë duke u shqyrtuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës dhe nga institucionet tjera përkatëse të Kosovës.

12. Qeveria e Kosovës vazhdoi të përkrahë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në

ushtri, duke pranuar se kjo duhet bërë përmes një ndryshimi kushtetues. Më 5 mars 2018, në një ceremoni të mbajtur në shtabin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë për shënimin e njëzetvjetorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Presidenti Thaçi po ashtu mbështeti transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri përmes një ndryshimi kushtetues, në partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior. Lidhshipi i Serbisë vazhdon ta kundërshtojë fuqishëm një transformim të tillë, të cilin e konsideron shkelje të rezolutës [1244 \(1999\)](#) të Këshillit të Sigurimit.

13. Incidentet që prekën komunitetet joshumicë përfshinin dëmet e shkaktuara objekteve me rëndësi për serbët e Kosovës. Më 12 shkurt 2018, u largua forcërisht një pllakë memoriale dhe baza e saj u dëmtua afër fshatit Zoçishtë në komunën e Rahovecit, që u dedikohet dy gazetarëve serb të Kosovës të cilët u zhdukën në vitin 1998. Më 1 mars 2018, në fshatin me shumicë serbe Hoçë e Madhe në komunën e Rahovecit, u largua flamuri serb dhe shtiza e tij u dëmtua në memorialin përkushtuar serbëve të Kosovës të cilët u zhdukën apo u vranë gjatë konfliktit të vitit 1998–1999.

### **III. Kosova veriore**

14. Progresi i ngadalshëm i hetimit për vrasjen e politikanit serb të Kosovës Oliver Ivanoviç, më 16 janar në veri të Mitrovicës, së bashku me ngjarjet e 26 marsit të prëshkruara më lart, e rriti indinjatën e popullit serb të Kosovës në veri. Hetimi për vrasjen e z. Oliver Ivanoviçit, fillimisht i drejtuar nga prokurorët serbë dhe shqiptarë në prokurorinë themelore të posaintegruar në Mitrovicë, u transferua

në Prokurorinë speciale të EULEX-it në Kosovë më 7 mars, për shkak të “kompleksitetit të lëndës”. Në fund të periudhës raportuese, nuk është raportuar asnjë përparim në këtë hetim. Duhet cekur se takimi i parë për shkëmbimin e informacioneve për hetimin me përfaqësuesit e ministrive të punëve të brendshme nga Beogradi dhe Prishtina, u mbajt në pikëkalimin kufitar administrativ 3 më 13 mars, mbi dy muaj pas vrasjes.

15. Përafërsisht 5,000 njerëz morën pjesë në funeralin e z. Ivanoviç më 17 janar, që u shpall zyrtarisht ditë zie në veri të Mitrovicës. Më 20 janar, Presidenti Vuçiç i shoqëruar nga Marko Gjuriq udhëtoi në Kosovë, duke vizituar lokacione të ndryshme në veri dhe në jug të lumit Ibër, duke përfshirë edhe vendin e vrasjes së z. Ivanoviçit në veri të Mitrovicës. Duke ju drejtuar turmës në Manastirin Banjska në komunën e Zveçanit, Presidenti Vuçiç theksoi rëndësinë e dialogut në mes të serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por edhe për mbështetjen e interesave të serbëve në Kosovë.

16. Më 18 shkurt, në komunën e Zubin Potokut u publikuan fletushka duke kërcënuar pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës të cilët ishin bashkuar Forcës së Sigurisë së Kosovës, pas fushatës së fundit të rekrutimit drejtuar pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. Në këto fletushak kritikohej edhe komuna, duke përfshirë kryetarin e saj, për mosndalimin e rekrutimit të tillë. Si reagim ndaj kësaj, KFOR-i ka shtuar patrullimin në këtë komunë, që vazhdoi deri në mes të marsit. Policia e Kosovës po ashtu ka zbatuar operacione speciale në këtë komunë, duke përfshirë edhe patrullimet statike dhe me ecje, për të ofruar mbrojtje më të madhe.

17. Dy tryeza të rrumbullakëta u organizuan në Kosovën veriore nën kornizën e dialogut të brendshëm



për Kosovën, të inicuar nga Presidenti Vuçiç, para takimit në veri të Mitrovicës që u ndërpre si pasojë e ngjarjeve të 26 marsit. Tryeza e parë e rrumbullakët, me rininë dhe studentët serbë të Kosovës, u mbajt në veri të Mitrovicës më 8 mars dhe u përqëndrua në rëndësinë e arsimit të lartë për serbët e Kosovës. E dyta — takim me transmetim televizi me përfaqësues të shoqërisë civile që u mbajt në veri të Mitrovicës më 14 mars, trajtoi largimin e serbëve nga Kosova dhe sfidat me të cilat përballen serbët e Kosovës në marrjen e dokumenteve personale. U mbajtën edhe diskutime në veri të Kosovës, si dhe gjashtë tryeza të rrumbullakëta shtesë në mbarë Serbinë, duke përfshirë segmente të ndryshme të shoqërisë serbe, sipas kornizës së Presidentit Vuçiç për dialogun e brendshëm mbi Kosovën.

18. Më 7 prill, Marko Gjuriq morri pjesë në ceremoninë e mesnatës së kërshëndellave ortodokse në Manastrin Banjska. Kjo ishte vizita e parë e z. Gjuriqit në Kosovë pas arrestimit të tij dhe dëbimit më 26 mars. Në këtë ceremoni morën pjesë rreth 400 njerëz.

19. Pas zgjedhjeve komunale të mbajtura në Kosovë në tetor të vitit 2017, kuvendet komunale të Leposaviçit dhe Zveçanit formuan grupet drejtuese të grave, me përkrahjen e kryetarëve përkatës të komunave të tyre. Më 7 mars, në prag të Ditës Ndërkombëtare të Grave, komuna e Zveçanit inauguroi grupet drejtuese të grave me një diskutim në paneli mbi rolin e grave në shoqëri. Këtë ngjarje, të sponsorizuar nga UNMIK-u, e hapi kryetari së bashku me përfaqësuesin tim Special.

#### **IV. Normalizimi i marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës**

20. Dialogu i përkrahur nga Bashkimi Evropian në mes të Beogradit dhe Prishtinës rifilloi pas një ndërprerje të gjatë. Ekipet e bisedimeve teknike të Beogradit dhe Prishtinës, të drejtuara nga Marko Gjuriq përkatësisht Avni Arifi, u takuan në Bruksel më 26 dhe 27 shkurt dhe sërish nga 19 deri më 21 mars. Ekipet rishikuan implementimin e marrëveshjeve të arritura, duke përfshirë edhe atë të lirisë së lëvizjes, menaxhimin e integruar të kufirit, asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, urën në Mitrovicë dhe energjinë. Ekipet u pjtuan se përparim i mëtejshëm në një sërë fushash do të kërkonte konsensus të nivelit më të lartë politik.

21. Më 23 mars, Përfaqësuesja e Lartë Mogerini u takua me Presidentin Vuçiç dhe Thaçin në Bruksel për të diskutuar, sipas kornizës së fazës së re të dilagut, implementimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese dhe përgatitjet për një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve. Pas takimit, Përfaqësuesja e Lartë Mogerini potencoi nevojën urgjente për fillimin e krijimit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Ajo po ashtu përsëriti zotimin e vazhdueshëm të shprehur nga të dy presidentët për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës, duke i kujtuar se përparimi i agjendave të tyre përkatëse për integrim në Bashkimin Evropian në mënyrë të prerë është i lidhur me progresin e dialogut.

22. Për më tepër, lidhur me ngjarjet e 26 marsit, Përfaqësuesja e Lartë Mogerini udhëtoi në Beograd, ku ajo u takua me Presidentin Vuçiç më 27 mars, për të diskutuar “zhvillimet e fundit dhe të ardhmen e dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian për

normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës”. Në një komunikatë të lëshuar pas takimit, Përfaqësuesja e Lartë e përsëriti rëndësinë që Bashkimi Evropian i jep dialogut dhe implementimit të marrëveshjeve të arritura.

23. Gjatë periudhës raportuese, Beogradi potencoi se i ka përmbushur gati të gjitha obligimet sipas marrëveshjeve të arritura sipas kornizës së dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian, ndërsa Prishtina nuk ka lëviz me krijimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, që është me rëndësi të madhe për Beogradin dhe për serbët e Kosovës. Në fjalime të ndara drejtuar mediave më 25 shkurt dhe 24 mars, zëvendësministri i parë dhe ministri i punëve të jashtme të Serbisë, Ivica Daçiç, paralajmëroi se Beogradi mund të tërhiqet nga zotimet sipas marrëveshjeve të arritura në Bruksel, nëse nuk do të ndërmerreshin hapa konkret e të shpejtë për themelimin e asociacionit/bashkësisë.

24. Më 5 prill, kryeministri Haradinaj lajmëroi vazhdimin e punës për hartimin e statutit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, që duhej përfunduar brenda katër muajve. Mirëpo, Lista Serbe, e përshkroi propozimin si të “papranchesëm”, duke theksuar se asociacioni/bashkësia duhet të themelohet në pajtim me marrëveshjen e Brukselit të 25 gushtit 2015, jo me Kushtetutën e Kosovës. Në këtë aspekt, Lista Serbe mbetet e shqetësuar se autoritetet e Kosovës do të insistojnë në respektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 23 dhjetor 2015, sipas të cilit disa dispozita në marrëveshjen e Brukselit të vitit 2015 nuk janë në pajtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës.

## **II.V. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet e**

## komunitetit

25. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), regjistroi tri kthime vullnetare në Kosovë të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. Gjithsej, UNHCR-ja ka regjistruar 27,792 kthime vullnetare nga pjesëtarë të komuniteteve joshumicë në Kosovë që nga viti 2000.

26. UNHCR-ja vazhdoi të mbështesë pjesëtarët e komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom në Kosovë në marrjen e dokumenteve personale dhe në zgjidhjen e çështjeve të gjendjes civile që, në mes tjerash, mundëson qasje në shërbime publike. Gjatë periudhës raportuese, UNHCR-ja ndihmoi 92 individë të marrin dokumente civile.

27. Më 14 shkurt dhe 15 mars, UNMIK-u, në partneritet me Ministrinë e Kosovës për Komunitete dhe Kthim, kontribuoi në organizimin e dy forumeve ndërkomunale të mbajtura në Pejë dhe në Gjiilan. Në këto forume u trajtuan strategjitë për rritjen e kthimeve dhe për rolin e organeve komunale në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

28. Gjatë periudhës nën shqyrtim, 23 komuna në jug të lumit Ibër rithemeluan komitetet respektive të komuniteteve, duke e rritur numrin gjithsej në 28 komuna të cilat i kanë krijuar mekanizmat e tilla detyruese kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e komuniteteve. Duhet theksuar se pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, duke përfshirë ashkalisht, kroatët, egjiptasit, malazezët, romët, serbët dhe turqit, përbëjnë rreth 53 për qind të pjesëtarëve të komiteteve të komuniteteve. Pjesëtarë të komuniteteve joshumicë

u emërtuan në pozita komunale kyçe në komunën e Prizrenit dhe Kamenicës.

29. Këshilli implementues dhe monitorues, i themeluar nga qeveria e Kosovës në shkurt të vitit 2013, për të monitoruar dhe mundësuar implementimin e Ligjit mbi zonat e posaçme të mbrojtura, me fokus në dispozitën që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore të Kishës ortodokse serbe në Kosovë, u mbledh sërish më 13 dhe 23 mars 2018, pas tri vitesh pasiviteti. Në këto takime, përfaqësuesit e Kishës ortodokse serbe ngritën shqetësimet e tyre lidhur me një plan të komunës së Deçanit për ndërtimin e një rruge transit për në Mal të Zi, përmes zonës speciale të mbrojtur të Manastirit të Deçanit. Duke reaguar ndaj kësaj, përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës e ripërsëritën zotimin e tyre për të respektuar zonën speciale të mbrojtur. Mirëpo, një vendim formal mbi këtë çështje akoma është në pritje.

30. Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës ka bashkëpunuar me departamentin e urbanizmit në komunën e Prizrenit, për të parandaluar aktivitetet e mëtejshme ilegale të demolimit në qendrën e mbrojtur historike të Prizrenit. Një ekip i inspektorëve të trashëgimisë kulturore nga Ministria ka bashkëpunuar me inspektorët komunalë për të identifikuar demolimet dhe ndërtimet e paligjshme në zonën e mbrojtur, dhe rastet e identifikuara ua dorëzoi autoriteteve gjyqësore.

## **VI. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

31. Më 5 shkurt, tri vite pas miratimit të ligjit mbi pranimin e statusit ligjor të viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit të Kosovës, dhe krijimin e

bazës ligjore për kompensimin e tyre, qeveria e Kosovës zyrtarisht nisi procesin e aplikimit për të mbijetuarit e dhunës seksual gjatë luftës që të fitojnë statusin ligjor si viktimë e luftës. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale autorizoi katër organizata joqeveritare që po specializohen në këtë fushë, të mbështesin procesin e aplikimit.

32. Gjatë periudhës raportuese, përpjekjet vazhduan të sigurojnë se sistemi i drejtësisë në Kosovë është në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Në fillim të shkurtit, qeveria shqyrtoi dhe miratoi një pako të amendamenteve kyçe të legjislacionit me të cilin rregullohet funksionimi i sistemit gjyqësor, duke përfshirë edhe Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi përgjegjësitë ndëshkimore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Më 13 prill, qeveria miratoi një projekt të ri të Kodit Penal të Kosovës, që përfshin, në mes tjerash, dënime më të ashpra për vepra që lidhen me korrupsionin dhe shpërdorimin e pozitës zyrtare. Duke ja paraqitur projektin e ri qeverisë, ministri i drejtësisë tha se kodi i ri do të jetë në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian, dhe Kosovës do t'i mundësojë që me sukses të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar.

33. Sistemi gjyqësor i Kosovës vazhdoi me marrjen e përgjegjësiave për kryesimin e lëndëve të reja të cilat deri tani ishin trajtuar nga EULEX-i. Për shembull, më 20 shkurt, një lëndë ku përfshihej një ish deputet i Kuvendit të Kosovës, Azem Syla, dhe 38 individë të tjerë, të akuzuar për shpronësimin e pronave shoqërore në Kosovë, duke rezultuar me shkaktimin e dëmit prej 30 milion eurosh buxhetit të qeverisë, u transferua nga EULEX-i tek gjyqtarët vendorë. Akuzat përfshinin mashtrimin, larjen e parave, krimin e organizuar dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare. Më 12 mars, z.

Syla u lirua nga paraburgimi dhe u la në arrest shtëpiak.

34. Në një rast tjetër, më 26 shkurt, Gjykata e apelit e përmbysi vendimin e Gjykatës themelore të Prishtinës, e cila në nëntor të vitit 2017 kishte dënuar tre pjesëtarë të Partisë Vetëvendosje, duke përfshirë edhe një deputet të Kuvendit, për hedhjen e granatës në ndërtesën e Kuvendit në vitin 2016. Lënda u dërgua për rigjykim. Po atë ditë, të pandehurit u liruan nga paraburgimi. Në një ngjarje tjetër më 9 mars, gjykata themelore e Gjakovës e liroi, për shkak të mungesës së provave, ish komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe aktualisht zëvendëskryeministër, Fatmir Limajn, për krime lufte lidhur me vrasjen e shqiptarëve të Kosovës në vitin 1998 në komunën e Malishevës, ku Limaj kishte shërbyer si komandant i zonës.

35. Më 21 mars, 12 persona u arrestuan, 8 në Kosovë dhe 4 në Slloveni, në lidhje me kontrabandimin e 300 emigrantëve nga Kosova për në Slloveni. Arrestimet ishin rezultat i një operacioni të përbashkët ku përfshihej Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës në Mitrovicë, Policia shtetërore e Sllovenisë, Prokuroria e shtetit të Sllovenisë, EULEX-i dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol).

36. Mandati i Prokurorit Special në Prokurorinë Speciale, David Schwendiman, përfundoi më 31 mars, ku zëvendësi i tij shërbeu si ushtrues detyre i Prokurorit Special deri në caktimin e pasardhësit. Në një zhvillim të ngjashëm më 14 mars, 40 avoaktë nga Kosova dhe nga jashtë, u akredituan të ofrojnë shërbime si avokat mbrojtës në rastet pranë Gjykatës Speciale të Kosovës.

37. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq thirri një takim më 27 shkurt të Grupit punues për persona të zhdukur lidhur me ngjarjet e viteve 1998–1999 në Kosovë. Në takim, delegacioni i Beogradit dhe i Prishtinës potencuan nevojën që Grupi punues të kalojë nga qasja humanitare në qasjen e bazuar në drejtësi, dhe të përqëndrohet në finalizimin e rasteve të pazgjidhura të personave të zhdukur.

38. Më 1 mars, Raportuesja Speciale në fushën e të drejtave kulturore, Karima Bennouna, e paraqiti raportin e saj për Serbinë dhe Kosovën në seancën e tridhjetë e shtatë të Këshillit mbi të Drejtat e Njeriut në Gjenevë. Raporti përfshin të gjeturat dhe rekomandimet pas vizitës së Raportueses Speciale në Serbi dhe Kosovë nga 3 deri më 14 tetor 2016. Përqëndrohet në të drejtën për të marrë pjesë në jetën kulturore, duke përfshirë edhe të drejtën për qasje dhe gëzim të trashëgimisë kulturore pa diskriminim, dhe thekson nevojën për një kornizë të duhur ligjore dhe institucionale.

39. Më 2 mars, u hap strehimorja e parë për viktimat e dhunës në familje në një rajon joshumicë në komunën e Novobërdës. Kjo strehimore do të ofrojë një shtëpi të përkohshme për viktimat e dhunës në familje, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike.

## **VII. Gratë, paqja dhe siguria**

40. Më 5 mars, në bashkëpunim me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN-Women), UNMIK-u drejtoi Ditën e tetë të Hapur Globale për gratë, paqen dhe sigurinë, që u përqëndrua në pjesëmarrjen politike të grave. Kjo ngjarje, që u hap nga Përfaqësuesi im Special, së bashku me nënkryetarin e Kuvendit të



Kosovës dhe shefen e UN-Women në Kosovë, mbledhi mbi 150 pjesëmarrës, duke përfshirë deputet të Kuvendit, zyrtarë qeveritarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo ngjarje, në mes tjerash, shërbeu si mundësi për të ndëgjuar përvojat e grave kandidate në zgjedhjet e vitit 2017 në Kosovë, për të diskutuar barrierat strukturore të pjesëmarrjes së grave në jetën politike në Kosovë, dhe për të rishikuar përdorimin e kuotës gjinore elektrorale. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për të siguruar që legjislacioni i Kosovës është në përputhje me standardet e përcaktuara në Ligjin për barazi gjinore, nevojën për të mbështetur gratë në pozita lidhshme brenda partive politike, dhe nevojën për trajtimin e normave patriarkale dhe stereotipeve lidhur me rolin e grave në politikë.

41. U mbajtën edhe disa ngjarje shtesë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Më 6 mars, KFOR-i organizoi një konferencë, duke bashkuar përfaqësues nga qeveria e Kosovës, organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare, duke u fokusuar në sfidat për sigurinë e grave në Kosovë, si dhe rolin e gruas si aktere të paqes dhe sigurisë. Më 8 mars, OSBE-ja me Ambasadën e Francës në Kosovë, organizuan një forum të nivelit të lartë mbi të drejtat pronësore të grave në Kosovë, që në mes tjerash trajtoi normat tradicionale që i pengojnë gratë të kërkojnë dhe të posedojnë pronë. Pjesëmarrësit theksuan ndikimin e mungesës së qasjes së grave në të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë në zhvillimet socio-ekonomike në Kosovë, dhe nevojën për të avancuar mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave.

42. Më 13 mars, organizata joqeveritare “Të Drejtat e Grave” nga veriu i Mitrovicës, në partneritet me organizatën për të drejtat e grave nga Mitrovica e jugut

“Mundësia” dhe me përkrahjen e UNMIK-ut, mbajtën takimin e tretë të dialogut për ndërtimin e besimit të quajtur “Gratë në Politikë”. Në këtë ngjarje, që mbledhi gra shqiptare dhe gra serbe të Kosovës nga veriu dhe jugu i Mitrovicës, u theksua se pjesëmarrja e grave në politikë mbetet e ulët në Kosovë, dhe prandaj ishte e nevojshme që gratë të cilat mbajnë pozita politike të ndajnë përvojat e tyre.

### **VIII. Partneritetet dhe bashkëpunimi**

43. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u implementoi dy masa për ndërtimin e besimit. E para mbështeti tri grupet multi-etnike të grave në Pejë, komunën e Klinës dhe të Istogut, në krijimin e shkathtësive sipërmarrëse të grave dhe ndihmën ofruar grave për fillimin e bizneseve të tyre. E dyta, në komunën e Istogut mbështeti krijimin e një qendre për komunitete dhe trajnimin e mbi 200 të rinjve me prejardhje të ndryshme etnike, për zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve.

44. UNMIK-u po ashtu vazhdoi të implementojë aktivitete programuese në fushën e ndërtimit të besimit, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Gjatë periudhës raportuese, u iniciuan 36 aktivitete, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin kosovar të Kombeve të Bashkuara, për të avancuar në mes tjerash qasjen në drejtësi, kapacitetet e drejtësisë së Kosovës dhe të institucioneve korrektuese për të trajtuar shkeljet e të miturve, dhe kapacitetet e agjencive ligjzbatuese për trajtimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunën në familje. Përveç kësaj, UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin kosovar të Kombeve të Bashkuara dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, u përgatit për një forum të Kosovës

për ndërtimin e besimit, i paraparë të mbahej nga 6 deri më 8 maj, duke bërë së bashku përfaqësues nga një spektër i gjerë i shoqërisë kosovare, duke përfshirë qeverisjen lokale, shoqërinë civile, intelektualë dhe mediat, si dhe grupet fetare, të rinisë dhe të grave.

45. Përfaqësuesi im Special vazhdoi vizitat e tij në komunat e Kosovës. Më 7 mars, ai vizitoi komunën e Zubin Potok-ut dhe të Zveçanit ku diskutoi zhvillimet e fundit, duke përfshirë edhe gjendjen e sigurisë me kryetarët e komunave. Në komunën e Zveçanit, ai hapi një ngjarje të drejtuar nga kryetari i kuvendit komunal dhe shefja e bordit drejtues të grave, ku u mbajt një diskutim i panelit për gjendjen e grave, të mbajtur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Po atë ditë, Përfaqësuesi im Special vizitoi gjykatoren në veri të Mitrovicës, ku kryetari i gjykatës themelore të Mitrovicës theksoi sfidat lidhur me përputhshmërinë me dispozitat e Ligjit mbi gjuhët. Më 14 mars, Përfaqësuesi im Special vizitoi komunën e Kamenicës, ku kryetari i komunës u ankua për mungesën e investimeve dhe mungesën e mundësive të punësimit në komunë, dhe theksoi progresin e bërë në barazinë gjinore në institucionet lokale, ku 6 nga 11 drejtorëve të posaçëmrtuar komunal ishin gra.

46. Më 11 prill në Prishtinë, UNMIK-u organizoi një seancë pune të një platforme ku përfshiheshin të rinj me prejardhje të përzier etnike me temën “Tregime nga pala tjetër”. Gra dhe burra të rinj diskutuan për sfidat e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, përfshirjen e rinisë në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe qendror, si dhe mënyrat e trajtimit të hendekut të zgjerimit të arsimit dhe punësimit, përfshirë edhe përmes iniciativave për ndërtimin e kapaciteteve për të rinjtë.

47. UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të certifikimit të dokumenteve. U procesuan një numër i përgjithshëm prej 929 dokumentesh, përfshirë edhe 451 lidhur me pensionet dhe 478 për gjendjen civile, siç janë diplomat e shkollës së mesme dhe ato universitare, dhe certifikatat e martesës, të lindjes dhe vdekjes. UNMIK-u vazhdoi të mundësojë ndërlidhjen në mes të autoriteteve të Kosovës dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL). Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u pranoi dhe procesoi 45 kërkesa për lëshimin e letërreshtimeve ndërkombëtare.

## **IX. Vrojtimet**

48. Unë jam i shqetësuar nga përkeqësimi i marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës, posaçërisht pas arrestimit të drejtorit të zyrës për Kosovë të qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriq, më 26 mars. Ju bëj thirrje të dyja palëve t'u shmangen veprimeve provokative dhe të përmbahen nga retorika nxitëse. Kërkoj nga lidershipi në Beograd dhe Prishtinë të vazhdojnë me trajtimin e çështjeve problematike përmes dialogut, dhe të tregojnë vullnetin politik të nevojshëm për sigurimin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve të tyre reciproke.

49. Sjellja e Policisë së Kosovës gjatë një operacioni të profilit të lartë siç ishte arrestimi i z. Gjuriq, që rezultoi me disa lëndime, është arsye për shqetësim. Për ngjarjet e 26 marsit nevojitet një hetim i detajuar, me veprime korrektuese nëse konstatohen lëshime në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

50. E theksoj, me sheqtësim, hapin e ngadalshëm të progresit në hetimin e vrasjes më 16 janar të

politikanit serb të Kosovës Oliver Ivanoviç. Përderisa nuk marrim përgjigje dhe drejtësi të besueshme, dyshimet reciproke dhe perceptimet e pasigurisë do të vazhdojnë të dëmtojnë përpjekjet për ndërtimin e besimit në mes të komuniteteve në mbarë Kosovën.

51. Dialogu i mbështetur nga Bashkimi Evropian në mes të Beogradit dhe Prishtinës duket se ka arritur në një qorrsohak tjetër pas rifillimit të shkurtër në mars — në nivelin teknik dhe politik. Ju bëj thirrje të dyja palëve që procesit të dialogut t'i japin një shtysë të re, në mënyrë që të sigurohet implementimi i plotë i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më sot.

52. Jam inkurajuar nga përpjekjet e vazhdueshme për funksionalizimin e gjyqësorit të integruar të Kosovës, në pajtim me marrëveshjet e arritura në mes të Beogradit dhe Prishtinës nën kornizën e dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian. Ju bëj thirrje institucioneve të përfshira të Kosovës të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për tejkalimin e pengesave të mbetura.

53. E përshëndes ratifikimin e marrëveshjes nga Kuvendi i Kosovës për caktimin e vijës kufitare me Malin e Zi, që është një indikacion i zotimit të Kosovës në perspektivën evropiane. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nga disa deputetë të Kuvendit për të penguar punën, madje edhe me mjete të dhunshme, Kuvendi arriti të përmbyllë një çështje që për një kohë shumë të gjatë e kishte larguar vëmendjen e tij nga çështje të tjera urgjente.

54. Edhe njëherë e përsëris thirrjen time për t'i kontribuar fondit të mirëbesimit, i cili u themelua pas punës së Panelit Këshillëdhënës të UNMIK-ut për të Drejtat e Njeriut, për përkrahjen e komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom, të prekur nga helmimi me plumb në

Kosovë. Kontributet në fondin e mirëbesimit do të përkrahin implementimin e projekteve që trajtojnë nevojat më urgjente të këtyre komuniteteve të cënueshme, posaçërisht në fushën e shëndetësisë, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.

55. I jam mirënjohës Përfaqësuesit tim Special, Zahir Tanin dhe tërë Misionit, për zotimin e tyre të palëkundur në promovimin e progresit për paqe dhe stabilitet afatgjatë për Kosovën dhe rajonin, në bashkëpunim me homologët e tyre lokalë dhe partnerët ndërkombëtarë. Falënderoj gjithashtu agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të bashkuara në terren, për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm me UNMIK-un, si dhe partnerët e kahmotshëm ndërkombëtarë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke përfshirë edhe Bashkimin Evropian, KFOR-in dhe OSBE-në.

## Aneksi I

### **Raporti i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë nga 16 janari deri më 15 prill 2018**

#### **1. Përmbledhje**

Më 21 mars, autoritetet ligjzbatuese të Kosovës, së bashku me Europolin dhe me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), e mbështetën një operacion të udhëhequr nga Sllovenia, për kapjen e trafikantëve të emigrantëve, si pjesë e një operacioni tejkuftar që synonte shpërndarjen e një grupi të krimin të organizuar në rrugën Ballkan.

Akoma ka sfida lidhur me efikasitetin e sistemit të gjykatave, veçanërisht shtyrjet e atypëratyshme të seancave dëgjimore, apo fillimi i vonshëm dhe seancat e zgjata padrejtësisht.

Ndërhyrjet politike dhe trajtimet preferenciale në Shërbimin Korrektues të Kosovës për disa të burgosur të profilit të lartë ende mbesin shqetësim. Kjo përfshin hospitalizimin e të burgosurve të profilit të lartë, që nuk janë në përputhje me rregulloret e shoqërimit të këtij shërbimi.

#### **2. Aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundimin e Ligjit**

##### **2.1. Ekzekutivi**

##### *Krimi i organizuar dhe korrupsioni*

Më 1 shkurt, një panel me një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it në Gjykatën themelore të Prishtinës, shpalli aktgjykimin kundër një të pandehuri dhe atë e shpalli fajtor për një pikë të akuzës

që ishte trafikimi me drogë. Të pandehurit iu shqiptua dënimi me burgim prej gjashtë vitesh. Në seancën e njëjtë dëgjimore, i pandehuri u lirua nga pesë akuza të tjera që lidheshin me trafikim droge, duke përfshirë edhe krimin e organizuar. Ai u lirua edhe nga akuza për një vrasje për shkak të mungesës së dëshmive.

Më 14 mars, një panel me një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it në Gjykatën themelore në Mitrovicë, shpalli vendimin e tij në një lëndë penale kundër dy të pandehurve, ku ata i shpalli fajtorë për trafikim të emigrantëve. Njëri u dënua me katër vite burgim dhe tjetri me dy vite dhe tre muaj burgim.

Më 21 mars, autoritetet ligjzbatuese të Kosovës, së bashku me Europolin dhe EULEX-in, përkrahën një operacion të udhëhequr nga Sllovenia për kapjen e 12 trafikantëve të emigrantëve, si pjesë e një operacioni tejkuftar, që synonte shpërndarjen e një grupi të krimit të organizuar i përfshirë në trafikimin e emigrantëve nga Kosova në Slloveni përmes rrugës së Ballkanit.

Më 29 mars, një panel me gjyqtarë të EULEX-it në Gjykatën themelore në Mitrovicë, e liroi një të pandehur të akuzuar për krim të organizuar dhe për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm.

### *Krimet e luftës*

Pas vrasjes së të pandehurit të vetëm në një lëndë për krime lufte, më 16 janar jashtë zyrës së tij në Mitrovicë, gjykimi kundër tij u përfundua.

Seancat kryesore vazhduan për lëndët e krimeve të luftës “Vukotiq I” dhe “Vukotiq II”. Përveç kësaj, lënda për krime lufte “Vukotiq III” ndodhet në Gjykatën e apelit pas paraqitjes së një ankese tjetër kundër aktvendimit për këtë aktakzue.



### *Dorëzimi i lëndëve dhe i dosjeve të tyre*

EULEX-i vazhdoi me dorëzimin e lëndëve, të dosjeve të lëndëve dhe dëshmimeve institucioneve të Kosovës. Prokurorët e EULEX-it /\* ia dorëzuan lëndët dhe dosjet e lëndëve Prokurorisë speciale të EULEX-it në Kosovë dhe Prokurorisë themelore të Mitrovicës. Në ndërkohë, gjyqtarët e EULEX-it vazhduan me transferimin e lëndëve homologëve të tyre vendorë.

### *Instituti i mjekësisë ligjore*

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it identifikuan mbetjet e një personi të zhdukur. Përveç kësaj, ata dorëzuan 2 mbetje individuale dhe 13 palë mbetjesh familjeve të tyre përkatëse.

Dy mjekë të mjekësisë ligjore të Kosovës me sukses përfunduan një kurs të avancuar të mjekësisë ligjore antropologjike të ofruar nga Universiteti Leicester, dhe kanë vazhduar paralelisht me trajnimin e tyre pa shkëputje nga puna për mjekësi ligjore antropologjike.

### *Të drejtat pronësore*

Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës mori vendim për 34 lëndë, 183 janë në pritje (nga të cilat 17 janë duke u përkthyer). Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje të privatizimit shpalli 2,471 vendime për lëndët e trupave gjyquese të shkallës së parë dhe përfundoi 539 lëndë të paneleve të Gjykatës së apelit. Një numër i përgjithshëm prej 21,329 lëndë janë në pritje për t'u zgjidhur nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

## **2.2. Fuqizimi**

### *Monitorimi i lëndëve*

Akoma ka sfida lidhur me efikasitetin e sistemit të gjykatave, duke përfshirë edhe shtyrjet e

atypëratyshme të seancave dëgjimore, fillimin e vonshëm të seancave dhe seancat e tejzgjatura, që shpesh rezultojnë me dëgjime joproduktive. Kjo ndodh kryesisht për shkak të rotacioneve të shpeshta të prokurorëve dhe riemërtimeve të papritura të gjyqtarëve.

Pas vrasjes së politikanit serb të Kosovës Oliver Ivanoviç më 16 janar, EULEX-i e ka monitoruar situatën dhe ka vepruar në koordinim me homologët relevantë. Më 26 shkurt, EULEX-i monitoroi një takim të përbashkët koordinues në Prokurorinë themelore të Mitrovicës, ku morën pjesë prokurorë serbë dhe shqiptarë të Kosovës dhe ekipet hetuese të policisë. Më 7 mars, me kërkesë të Kryeprokurorit, lënda Ivanoviç u transferua në Prokurorinë speciale të Kosovës, për shkak të kompleksitetit të lëndës. Më 13 mars, EULEX-u përkrahu takimin e parë për shkëmbimin e informacioneve për hetimin në mes të përfaqësuesve të Policisë së Kosovës dhe të Serbisë në pikëkalimin kufitar administrativ 3.

Pas arrestimit të Marko Gjuriqit më 26 mars, EULEX-i, me kërkesë të Policisë së Kosovës, u aktivizua si përgjegjës i dytë për sigurinë dhe patrolloi në viset relevante në veri të Kosovës.

### *Gjyqësori*

Në gjyqësor akoma ka sfida të dukshme lidhur me procesin e përzgjedhjes në pozita të larta. EULEX-i ka monitoruar procesin e rizgjedhjes për pozitat e kryetarëve në Gjykatën Supreme dhe në Gjykatën e Apelit, pasi procesi fillestar ishte kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese, si dhe procesi i zgjedhjes së pesë kryetarëve në gjykatat themelore, dhe gjyqtarë mbikëqyrës në degët e gjykatave. Nevojitet punë shtesë që këto procese të rekrutimit të implementohen

në mënyrë të paanshëm dhe transparente, duke ju përmbajtur në mënyrë strikte rregullores së punës dhe të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Proceset përzgjedhëse për 21 prokurorë dhe 39 zyrtarë ligjorë në sistemin prokurorial janë vlerësuar pozitivisht, në pajtim me rregullat dhe rregulloret në fuqi, duke demonstruar zotimin e jashtëzakonshëm të komisionit përzgjedhës që punën ta përfundojë në mënyrë efikase dhe brenda afateve shumë të shkurtra kohore.

Nga pakoja e ligjeve e vitit 2016 kanë mbetur vetëm edhe dy rregullore që duhet miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës: rregullorja për gjyqtarë laikë dhe rregullorja për bashkëpunëtorë profesional. Mirëpo, këto janë pushuar deri në miratimin e ndryshimeve në Ligjin mbi gjykatat dhe në Ligjin mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Pas miratimit, të gjitha rregulloret e miratuara paraprakisht duhet rishikuar sërish për të reflektuar ndonjë ndryshim të bërë.

### *Shërbimi Korrektues i Kosovës*

Çështje shqetësuese në Shërbimin Korrektues të Kosovës mbasin ndërhyrjet politike dhe trajtimet preferenciale të një grupi të zgjedhur të të burgosurve të profilit të lartë. Që nga shkurti i viti 2018, EULEX-i ka vërejtur një rritje të numrit të hospitalizimeve të të burgosurve të profilit të lartë, së bashku me mungesën e përputhjes së vazhdueshme me rregulloret e shoqërimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, veçanërisht për sa u përket të burgosurve nga qendra korrektuese në Dubravë.

Si reagim ndaj kësaj, EULEX-i përgatiti raport për panelin e privilegjeve në qendrën korrektuese në Dubravë me disa rekomandime për avancimin e

funksionimit të tij. Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe panelit për lirim me kusht gjithashtu i rekomandoi që ata të sigurohen që, në pajtim me kushtet ligjore, të gjithë të burgosurit të marrin një prëgjigje me shkrim brenda tre ditësh për kërkesën e tyre për të marrë informacione lidhur me vendimin e panelit për lirim me kusht. EULEX-i në vazhdimësi kishte marrë ankesa nga të burgosurit në Qendrën Korrektuese të Dubravës se paneli për lirim me kusht nuk u kishte dhënë informacione në rast të refuzimit të kërkesës së tyre, kështu duke i privuar ata nga mundësia e rishqyrtimit të rasteve të tyre.

Vendi i punës për pozitën e drejtorit të përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës u hap sërish në dhjetor 2017/janar 2018, pas anulimit të procesit të parë përzgjedhës në korrik të vitit 2017. Nga 11 aplikacionet e pranuar, 5 kandidatë u përfshin në listën e ngushtë dhe u ftuan për intervistë. Ky proces i drejtuar nga partneri bashkë-implementues i projektit nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, për ndihmë në rekrutimin e zyrtarëve të lartë në institucionet e Kosovës, dhe i monitoruar nga EULEX-i, rezultoi me propozimin e tre kandidatëve ministrit të drejtësisë, që do të përfundojë me paraqitjen e një kandidati qeverisë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon të pësojë nga infrastruktura, dobësitë në rekrutimin e stafit dhe nga menaxhimi. Që nga janari, stafi dhe menaxhmenti në qendrën korrektuese në Lipjan kanë dështuar në marrjen e masave adekuate për ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes për të miturit në paraburgim, të cilët u vunë zjarrin qelive, rrënuan objektet dhe u vetlënduan. Kontrabandimi, kryesisht i telefonave celularë dhe i pajisjeve të ngjashme, posaçërisht në qendrën

korrektuese në Dubravë, mbetet problem, dhe sasia e rritur e narkotikëve që po gjindet tash së voni, me gjithë efektet e tyre anësore, është tejet shqetësuese dhe kërkon veprim të menjëhershëm.

### *Policia e Kosovës*

Në përpjekje për të përmirësuar balancin etnik dhe gjinor, nga 270 pozita të lira që duhej plotësuar në fushatën e rekrutimit që duhet të mbahet në tremujorin e dytë të vitit 2018, Policia e Kosovës po e shqyrton mundësinë që 30 për qind e këtyre pozitave të plotësohen me femra. Ndonëse përkrahja publike për rritjen e përfaqësimit të femrave në polici dhe përdorimi i kuotës janë inkurajuese, nevojitet veprim shtesë afirmativ për të mbështetur këtë iniciativë. Veprimi afirmativ i ndërmarrë nga Policia e Kosovës për të inkurajuar policët në shërbim nga pakicat për të aplikuar në njësinë e operacioneve speciale Pristinë-Mitrovicë, ishte një zhvillim pozitiv. Mirëpo, deri më sot, nuk ka pas aplikantë të mjaftueshëm.

### *Inspektorati Policor i Kosovës*

EULEX-i po ashtu ka vëzhguar me shqetësim ndërhyrjen e paligjshme të vazhdueshme, dhe presionin e raportuar brenda dhe jashtë Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Njësisë së Policisë së Kosovës për krime ekonomike. Më 5 mars, Gjykata themelore e Prishtinës e anuloi si të paligjshëm procesin e prëzgjedhjes për 17 pozita për hetues dhe inspektorë në Inspektoratin Policor të Kosovës. Kadidatët e mëparshëm të suksesshëm kishin ngritur padi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Inspektoratit Policor të Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme ka parashtruar ankesë kundër vendimit.

### *Mjekësia ligjore*

Më 2 mars, EULEX-i, në partneritet me UN-Women, mbështeti takimin e parë nga një sërë takimesh pune me përfaqësues të Policisë së Kosovës, me Kryeprokurorin, me Institutin për mjekësi ligjore dhe me Agjencinë e Kosovës për mjekësi ligjore. Qëllimi i takimeve është të mbështetet dhe të fuqizohet bashkëpunimi në mesin e të gjitha agjencive partnere për identifikimin, marrjen, analizimin dhe paraqitjen e dëshmive të mjekësisë ligjore në hetime të dhunës seksuale dhe asaj gjinore, duke përfshirë edhe përmes zhvillimit të një procedure operacionale standarde ndërinstitucionale.

#### *Dialogu i përkrahur nga Bashkimi Evropian*

EULEX-i vazhdoi të udhëheqë Prishtinën dhe Beogradin, në nivelin përkatës, dhe të përkrahë takimet për menaxhimin e integruar të kufirit. Përveç kësaj, EULEX-it i është kërkuar të mbështesë dhe të kontrollojë çështjet lidhur me implementimin e protokollit teknik për menaxhimin e integruar të kufirit. Më në fund, pas nëntë muajsh pasiviteti, ministri i punëve të brendshme mori rolin e koordinatorit të ri nacional për menaxhimin e integruar të kufirit, duke premtuar jetësimin e implementimit të planit të veprimt për menaxhimin e integruar të kufirit dhe krijimin e qendrës për menaxhimin e kufirit. Mirëpo, ministri dha dorëheqje në prill.

Sa u përket pikëkalimeve të përbashkëta të përhershme që duhet të hapen nga Prishtina, punët ndërtimore janë duke vazhduar në Merdarë dhe Mutivodë. Asnjë përparim nuk është bërë në pikëkalimet e përbashkëta në Bërnjak dhe tri pikëkalimet e përbashkëta të përhershme që duhet të hapen nga Beogradi.

Sa i përket implementimit në nivel teknik të marrëveshjes së vitit 2011 për lirinë e lëvizjes, u mbajt një takim i nivelit të ekspertëve në mes ekipeve të Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, nga 19 deri më 21 mars, sipas kornizës së dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian. Ky takim ishte një mundësi e mirë për ekipin e Prishtinës të paraqesë përparimin e bërë deri më sot. Mirëpo, akoma ka sfida lidhur me implementimin e marrëveshjeve përfundimtare, ashtu siç u pajtuan në shtator të vitit 2016. Këto sfida ndër të tjera janë implementimi i një regjimi më të ashpër, procesi i regjistrimit të automjeteve në veri të Kosovës, zyrat e sigurimit bazuar në marrëveshjen për sigurime dhe njohjen e dokumenteve të gjendjes civile të lëshuara nga strukturat paralele.

Më 16 mars, pas udhëzimeve të EULEX-it, Ministria e Punëve të Brendshme nënshkroi një udhëzim administrativ për regjistrimin e automjeteve me targën KS, duke përfshirë edhe dy vendime të ndërlidhura me këtë. Njëri vendim lejonte vazhdimin e procesit për ndërrimin e përkohshëm të targave me shkronjat RP për targat me shkronjat KS ose RKS, që ishte mbyllur në gusht të vitit 2017, përkundër faktit që kishin mbetur edhe 610 automjete me targa të përkohshme RP. Vendimi tjetër garantonte lirim nga taksa për regjistrimin e automjeteve me targa KS ose RKS, për pronarët e automjeteve që kishin targa të ish Republikës jugosllave (FRY) apo targa të ngjashme.

Lidhur me integrimin e 39 individëve të mbetur nga stafi administrativ i ish Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në zyrat komunale të gjendjes civile në veri të Kosovës, qeveria e Kosovës miratoi një vendim për financim të stafit shtesë. Pasi të miratohet vendimi nga ministri i financave, Ministria

për Administrim të Pushtetit Lokal e Kosovës mund të vazhdojë me procesin e rekrutimit.

### *Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve*

Për të fuqizuar hetimet dhe ndjekjen penale të krimeve lidhur me abuzimet seksuale dhe dhunës në familje në Kosovë, EULEX-i, së bashku me Policinë e Kosovës dhe me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, organizuan një trajnim mbi mjekësinë ligjore dhe teknikat e marrjes në pyetje për rreth 50 hetues të Policisë së Kosovës.

EULEX-i po ashtu mbajti një punëtori për policimin e drejtuar nga inteligjenca dhe planifikimin strategjik për Policinë e Kosovës. Ky trajnim u fokusua në integrimin e policimit të drejtuar nga inteligjenca në politikat, procedurat dhe aktivitetet e Policisë së Kosovës, në nivel menaxherial.

EULEX-i, së bashku me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe me përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë, organizoi dy kurse trajnimi për prokurorët dhe zyrtarët e prokurorisë së Kosovës. I pari, për instrumentet e drejtësisë ndërkombëtare penale për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të luftës nën juridiksionin e Kosovës, synonte rritjen e aftësive të prokurorëve të Kosovës për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës me zbatimin e mjeteve ligjore të drejtësisë ndërkombëtare penale. I dyti, për komunikimin me media, synonte rritjen e aftësive të prokurorëve të Kosovës në komunikim me mediat dhe trajtimin e rasteve të ndjeshme.

### **3. Çështje tjera kyçe**

Asgjë e rëndësishme për t'u raportuar.



## Aneksi II

### **Dhomat e posaçme dhe Prokuroria e posaçme**

Më 14 mars 2018, pas një vlerësimi të ashpër të të gjithë kandidatëve, 40 avokatë u pranuan në listën e mbrojtësve të specializuar dhe mbrojtësve të viktimave. Reagimi për hapjen e listave ka qenë pozitiv. Procesi i aplikimit mbetet i hapur dhe Dhomat e posaçme vazhdojnë të pranojnë aplikacione.

Për avancimin e mandatit të tyre për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve, të viktimave dhe të tjerëve që dalin para gjykatës, Dhomat e posaçme kanë vazhduar të fokusohen në fuqizimin e sistemeve të përgjegjësisë duke miratuar kodin e etikës profesionale për interpretë dhe përkthyes më 13 mars, vazhdojnë punën për kodin e sjelljes profesionale për avokatë, dhe përfundojnë rregulloret për ndihmë juridike, në harmoni me praktikat më të mira për sigurimin e ndihmës ligjore për të akuzuarit dhe viktimat.

Më 15 dhe 16 mars, gjyqtarët e Dhomave të posaçme u mbledhën në Hagë për takimin e tyre të tretë. Gjatë këtij takimi, gjyqtarët dëgjuan prezentime informative dhe zhvilluan diskutime me njësitë e regjistrimit, që drejtpërsëdrejti përkrahin dhe ndihmojnë procedurat gjyqësore. Gjyqtarët po ashtu u informuan për të gjitha aktivitetet e realizuara nga shërbimi i administrimit gjatë tërë vitit paraprak, dhe diskutuan për veprimet në të ardhmen. Pas diskutimeve në takim, kryetari caktoi një grup prej tre gjyqtarësh të identifikojnë tema relevante për efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të ardhshme. U caktua edhe një gjyqtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Kushtetuese për të identifikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të

Kosovës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastet e zbatueshme, që është e rëndësishme për punën e ardhshme të Dhomave të posaçme.

Dhomat e posaçme vazhdojnë të angazhohen në bashkëpunim të ngushtë me shtetin nikoqir në mënyrë që të mundësohet puna e tyre, duke përfshirë edhe renovimin e objektit të ardhshëm të gjykatës në Hagë. Më 25 janar, administratori i gjykatës u takua me Ambasadorin për organizata ndërkombëtare të Mbretërisë së Holandës, dhe më 29 mars dhe 11 prill zëvendësadministratori mori pjesë në takimet e komitetit drejtues lidhur me renovimin e objektit.

Dhomat e posaçme vazhdojnë të priorizojnë aktivitetet e tyre në terren për të siguruar që mandati i tyre të kuptohet drejt, dhe për të nxitur komunikimin direkt me komunitetet e prekura. Në janar, u nënshkrua një marrëveshje për grante me qeverinë e Zvicrës për shtimin e aktiviteteve në terren të Dhomave të posaçme dhe të Prokurorisë speciale në Kosovë gjatë dy viteve, duke u mundësuar Dhomave të posaçme të detajojnë më tutje punën e tyre në terren dhe të shtojnë aktivitetet e planifikuara fillimisht.

Nga 5 deri më 8 shkurt, Dhomat e posaçme mbajtën konsultime me shoqërinë civile në Kosovë për aktivitetet e ardhshme në terren. Më 6 shkurt, shefi i zyrës së mbrojtjes dhe shefi i zyrës për pjesëmarrjen e viktimës u takua me pjesëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës, në mënyrë që të ofrojnë informacione teknike për aplikimin dhe pranimin në listën e mbrojtësve. Në mars, shefi i Njesisë për informim publik dhe komunikim i Dhomave të posaçme dhe shefi i zyrës për pjesëmarrjen e viktimës, mbajtën takime për aktivitetet në terren me 115 përfaqësues të

grupeve të grave nga Rrjeti i grave të Kosovës, dhe me pjesëtarë të shoqërisë civile në veri të Mitrovicës.

Më 21 mars, zëvendësadministratori, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Qendra për të Drejtën Humanitare, mbajtën një diskutim paneli në Prishtinë, ku përfaqësuesit e Dhomave të posaçme i njoftuan organizatat joqeveritare, avokatët dhe pjesëtarët e komunitetit diplomatik, për mandatin dhe strukturën e Dhomave. Në shkurt dhe mars, përfaqësuesit e Dhomave të posaçme po ashtu mbajtën një sërë takimesh individuale me përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarë, organizata ndërkombëtare dhe me përfaqësues diplomatikë në Prishtinë. Dhomat e posaçme vazhdojnë të udhëheqin vizita grupe përmes programit të vizitorëve.

Dhomat e posaçme kanë fuqizuar edhe më shumë komunikimin me Bashkimin Evropian dhe me partnerët ndërkombëtarë. Më 29 janar, administratori dhe shefi i kabinetit të Presidentit, njoftuan delegatët e Komitetit të Këshillit të Bashkimit Evropian për aspekte civile të menaxhimit të krizave, për aktivitetet e administratës dhe Dhomave. Më 19 mars, Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovë, Igor Sholtes, u takua me krerët e Dhomave të posaçme dhe të Prokurorisë Speciale në Hagë. Më 21 mars, Dhomat e posaçme pritën një vizitë nga Partia e Punës së Këshillit Evropian për rajonin e Ballkanit perëndimor. Angazhimi i Dhomave të posaçme me shtete individuale anëtare të Bashkimit Evropian, me shtete të treta kontribuese dhe me shtete të tjera vazhdon, dhe është shumë i përqendruar në marrjen e mbështetjes për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe zbatimin e dënimeve.

Në pajtim me mandatin e tij të përcaktuar me ligjin special, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht të

vitit 2015, Prokuroria speciale ka vazhduar hetimin për pretendimet e përfshira në raportin e janarit të vitit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të titulluar “Trajtim johuman i njerëzve dhe trafikim i paligjshëm i organeve njerëzore”, që e morri nga Grupi veprues special investigativ në shtator të vitit 2016. Gjatë muajve të fundit, Prokuroria speciale gjithashtu ka bërë rishikim sistematik të të gjitha dëshmive që i posedon, në përputhje me kushtet e parapara në Rregulloren e procedurës dhe dëshmive.

David Schwendiman, i cili u caktua Prokuror special në shtator të vitit 2016, u tërhoq më 31 mars të vitit 2018, kur i skadoi mandati me kohë të caktuar si zyrtar i lartë për punë të jashtme në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga largimi i z. Schwendiman, Kwai Hong Ip, zëvendës prokurori special, ka shërbyer si ushtrues detyre i Prokurorit special me autoritetin e njëjtë si Prokurori special, dhe nuk ka pas ndërprerje të punës së Prokurorisë speciale. Ligji special, në mes tjerash, i jep Prokurorit special autoritetin të kërkojë nga institucionet e Kosovës ta ndihmojnë atë. Kur ka qenë në interes të hetimeve, është kërkuar ndihmë dhe ajo ndihmë është ofruar deri më sot. Prokurori special do të vazhdojë të kërkojë ndihmë nga çdo person dhe çdo institucion, vendor apo ndërkombëtar, për të ndihmuar hetimin dhe për të siguruar që ai të bëhet në mënyrë objektive, profesionale, të paanshme, të plotë dhe të mirë. Ndihma nga autoritetet në Beograd dhe Prishtinë, si dhe nga Bashkimi Evropian dhe nga komuniteti më i gjerë ndërkombëtarë, është thelbësore. Prokuroria speciale kërkon angazhimin e vazhdueshëm dhe përkrahjen e plotë të bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve individuale në të gjitha aktivitetet e saj.



## Aneksi III

### Përbërja dhe fuqia e komponentës së policisë të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

(nga 15 prill 2018)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Austria	1
Bullgaria	1
Finlanda	1
Gjermania	2
Hungaria	1
Federata ruse	2
Turqia	1

**Gjithsej** **9**

### Përbërja dhe fuqia e komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

(nga 15 prilli 2018)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Çekia	2
Polonia	1
Moldavia	1
Rumania	1
Turqia	1
Ukraina	2

**Gjithsej** **8**



Map No. 4133 Rev. 74 UNITED NATIONS  
April 2018 (Colour)

Department of Field Support  
Geospatial Information Section (formerly Cartographic Section)

